

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7946
E premte, 6 dhjetor 2024
Çmimi 0.50 €

Bardhyl Mahmuti shpreh keqardhje për reagimin ndaj deklaratës së ish-presidentit Thaçi



FAÇE 9

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SPECIALJA VAZHDON GJAHUN NDAJ UÇK-së

FAÇE 4-5

- Gjykata Speciale arreston Isni Kilajn, Fadil Fazliun dhe Bashkim Smakajn



Gjykata Speciale ka arrestuar të enjten ish-kryetarin e Malishevës, Isni Kilajn, vëllanë e dy dëshmorëve, Fadil Fazliun dhe ish-drejtorin e AKI-së, Bashkim

Smakajn. Po ashtu, Specialja ka bastisur shtëpinë e ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi. Ndaj këtyre arrestimeve kanë reaguar familjarët, përfaqësuesit e

organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe të partive politike. Ata e kanë akuzuar Specialen së është duke e vazhduar gjahun ndaj UÇK-së dhe njerëzve të saj

MINISTRAT NGA REPUBLIKA SËRPSKA BOJKOTOJNË TAKIMIN SHKAKU I VIZITËS SË KURTIT NË SARAJEVË

F. 3



AKTIVITETI I SHTUAR I GJYKATËS SPECIALE PARA ZGJEDHJEVE NË KOSOVË

F. 5

Reagim i KMDLNj-së



OPINION

LUFTA HIBRIDE NË KOSOVË - E VËRTETA, TRILLIME DHE SPEKULIME

F. 5

Shkruan:
Hajdin ABAZI



AKTUALE



DJALI I SHKURTE FEJZËS I BASHKOHET PDK-SË, NË GARË PËR DEPUTET

F. 3

EMËRIMI I GRUAS SË ALIUT DHE NIPIT TË BISLIMIT NË BORD TË KOSTT-IT, KDI: SHEMBULL FLAGRANT I NEPOTIZMIT

F. 3

EKONOMI



UJI NË KUFIRIN E TENSIONUAR: A MUND T'IA NDERROJË SERBIA KAHUN IBRIT?

F. 8

KEK-u: ËSHTË NDALUR NJËSIA B2, DO TË KRYHET NJË KONTROLL TEKNIK I PAJISJEVE

F. 8

SPORT

FFK-JA KA PROCEDUAR NË CAS ANKESËN NDAJ VENDIMIT PËR NDESHJEN RUMANI - KOSOVË

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Protestojnë punëtorët shëndetësorë

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Përfaqësuesja e mantelbardhëve, Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës, në protestën e mbajtur të enjten para Kuvendit të Kosovës, ka shprehur pakënaqësitë për ndërprerjen e dialogut social me Ministrinë e Shëndetësisë, mospajtimin me propozimin e qeverisë për një rritje të vogël të koeficientit prej 0.5, mosnënshkrimin e

Kontratës Kolektive Sektoriale, si dhe injorimi i protestës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë ndaj kërkesave të FSSHK-së. Kryetarja e FSSHK-së, Tevide Imeri, ka theksuar se kërkesat janë të arsyeshme dhe kërkojnë të plotësohen nga institucionet përkatëse të vendit. "Kërkesat janë të njëjta sikur në protestat e kaluara. Çështja tjetër është moszbatimi i aktgjyqimit nga Gjykata Kushtetuese e cila i njeh

të drejtat që kemi pasur më herët siç është zbritja në pagë që po na ndodh për çdo ditë. Çështja tjetër është edhe ulja e përvojës së punës nga 0.5 në 0.25", tha Imeri. Ajo e kritikoi Vitinë se nuk ka vizituar asnjëherë klinikat e që, sipas tij, "ministri Vitia shkon vetëm kur prehën shiritat për përrurime". Ajo ka paralajmëruar se nëse nuk ka ndryshim, do t'i vazhdojnë protestat.



Ministrat nga Republika Sërpska bojkotojnë takimin, shkaku i vizitës së Kurtit në Sarajevë

SARAJEVË, 5 NËNTOR - Ministrat nga Republika Sërpska (RS) nuk do të marrin pjesë të enjten, më 5 dhjetor, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës (BeH), për shkak të vizitës së kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në Sarajevë, njoftoi zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, Stasha Kosharac, raporton agjencia Srna. Ai tha se vendimi është marrë pas konsultimeve në kabinetin e tij, ku morën pjesë ministri i Financave në Këshillin e Ministrave, Srxhan Amixhiq, zëvendëskryetari i Mbrojtjes, Aleksandar Goganoviq, zëvendëskryetari i Çështjeve Civile, Marijana Mujiq, dhe zëvendëskryetari i Komunikacionit dhe Transportit, Ognjen Janjiq. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, do të mbërrijë në Sarajevë të enjten në mëbrëmje, konfirmoi një ditë më parë për Radion Evropë e Lirë, Adil



Kullenoviq, kryetar i organizatës joqeveritare Shoqata e Intelektualëve të Pavarur "Krug 99". Ai tha se Kurti vjen për të marrë pjesë në një sesion të organizuar nga kjo shoqatë një ditë më vonë në Sarajevë, ku do të mbajë një fjalë hyrëse. "Në sesion do të diskutohet për marrëdhëniet në rajon", tha Kullenoviq për REL-in. Vizita u konfirmua të enjten edhe nga Qeveria e Kosovës, e

cila tha në një njoftim se Kurti do të qëndrojë për një vizitë të shkurtër në Sarajevë, ku do të ketë takime me përfaqësues të institucioneve dhe përfaqësues politikë, si dhe do të marrë pjesë në një organizim të organizatës joqeveritare "Asociacioni i Intelektualëve të Pavarur Krug 99". "Ky udhëtim i kryeministrit në Bosnjë-Hercegovinë ishte paraparë të ndodhte në kuadër të pjesëmarrjes së tij në Samitin

e Liderëve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian që planifikohej të mbahej më 4 dhe 5 dhjetor në Neum. Për shkak disa problemeve të cilat tashmë i ka bërë të njohura organizatori, ky samit është anuluar", tha qeveria për Radion Evropë e Lirë. Këshilli i Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës ka marrë vendim për ta anuluar samitin e liderëve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian (BE) sepse ka dështuar tenderi për organizimin e kësaj ngjarjeje. Kryetari i entitetit serb të Bosnjë-Hercegovinës, Republika Sërpska, Millorad Dodik, deklaroi se ardhja e Kurtit në Sarajevë do ta komplikojë situatën në Bosnjë-Hercegovinë. "BeH nuk e ka njohur Kosovën. Ne nuk do të lejojmë që shqiptarët nga ai rajon të hyjnë me letërnjoftim", tha Dodik, sipas raportimit të Srnas.

Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova nuk e kanë njohur njera-tjetrën për shkak të kundërshtimit të Republikës Sërpske, në krye të së cilës është Dodik, i cili ka orientim prorus dhe është i sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara për minimin e Marrëveshjes së Dejtonit. Kurti kishte deklaruar në mes të tetorit, gjatë samitit të Procesit të Berlinit, se Kosova nga 1 janari 2025 do t'i lejojë qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës të hyjnë me letërnjoftim. Marrëveshja që do ta hiqte regjimin e vizave midis Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës dhe do t'u mundësonte qytetarëve të këtyre dy vendeve të udhëtojnë pa viza, ende nuk është ratifikuar në Parlamentin e Bosnjë-Hercegovinës. Ajo po bllokohet nga përfaqësuesit e Republikës Sërpske, të udhëhequr nga Lidhja e Socialdemokratëve të Pavarur e Millorad Dodikut.

Kuvendi miraton në parim Projektligjin për Byronë Shtetërore

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, me 60 vota për, asnjë kundër dhe vetëm një abstencion. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka deklaruar se konfirmimi kushtetues i konfiskimit civil është ndër çështjet më të rëndësishme si një instrument legjitim për luftën kundër korrupsionit. "Për të



sqaruar, qeveria nuk ka përpiluar një projektligj të ri, por vetëm janë adresuar në mënyrë specifike çështjet që Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar në

kundërshtim me Kushtetutën. Një ndër çështjet më të rëndësishme është konfirmimi i kushtetutshmërisë së konfiskimit civil, si një

instrument legjitim dhe proporcional për luftën kundër korrupsionit në sektorin publik, pra një arritje e madhe e shtetit të së drejtës. Çështjet kryesore të adresuara përfshijnë retroaktivitetin e ligjit, nevojën për qartësi në lidhje me periudhat kohore brenda të cilave byroja shtetërore mund ta verifikojë pasurinë e fituar kundërligjshëm, gjithashtu përfshin përbërjen e komisionit mbikëqyrës për respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve.

Sa i përket çështjes së retroaktivitetit të ligjit, si një nga çështjet kryesore të kësaj nisme Gjykata Kushtetuese nuk e ka refuzuar parimisht retroaktivitetin, por ka theksuar se ai duhet të zbatohet me kujdes duke respektuar parimin e proporcionalitetit", tha Haxhiu. Deputeti nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Driton Selmanaj, ka thënë se ky dokument është me elemente kundërkushtetuese dhe, si i tillë, nuk duhet të kalojë për miratim.

Kuvendi miraton Projektligjin për ndalimin e pijeve energjike për personat nën 18 vjeç

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar të enjten Projektligjin për ndalimin e shitjes së pijeve energjike nën moshën 18 vjeç. Për këtë projektligj kanë votuar 62 deputetë.

Ky projektligj ishte propozuar nga gjashtë deputetë të Kuvendit të Kosovës. Sipas deputetes Fitore Pacolli-Dalipi, Projektligji për ndalimin e pijeve energjike për personat nën moshën 18

vjeç ka për qëllim ta mbrojë shëndetin e fëmijëve dhe grupin e ndjeshëm ndaj efekteve negative që sjellin pijet energjike. Projektligji, po ashtu, parasheh sanksione

kundërvajtëse, me gjobë deri në 2 mijë euro për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik që shet, ofron ose reklamon për shitje pije energjike në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.



Haradinaj premton rritje pagash prej 50-përqindësh në sektorin e arsimit

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kandidati për kryeministër, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të enjten një bashkëbisedim me studentët e Universitetit Amerikan në Kosovë (A.U.K). Ai ka thënë se këta studentë janë një gjeneratë e jashtëzakonshme e të rinjve tanë që po përgatiten për të ardhmen. "Ndava me ta vizionin tonë për transformimin e arsimit të lartë në Kosovë. Nuk ka më kohë për premtime - duhet

veprim i menjëhershëm dhe reforma rrënjësore. Çka do të bëjmë? Rritje të buxhetit për arsimin në 6 % të GDP-së; 50 % rritje page për të gjithë punëtorët e arsimit; Implementim të modelit gjerman të arsimit dual; Investime të mëdha në fushat STEM; Trajtim të barabartë për universitetet publike dhe private; Digjitalizim të plotë të procesit mësimor", ka thënë Haradinaj. Ai ka thënë se studentët e

Universitetit Amerikan e bindën edhe një herë se Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm. "Por ky talent kërkon përkrahje institucionale dhe kushte të duhura. Me planin tonë do të ndërtojmë një sistem arsimor që përgatit të rinjtë për tregun e punës dhe që i mban ata në Kosovë. Bashkë do ta bëjmë Kosovën fituese - një qendër rajonale të dijes dhe inovacionit!", ka deklaruar Haradinaj.



Djali i Shkurte Fejzës i bashkohet PDK-së, në garë për deputet



PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka njoftuar se partisë i është bashkuar edhe diplomati Arbër Behluli, i cili është djali i ikonës kulturore, këngëtares së shquar Shkurte Fejza, si dhe nipi i heroit Azem Behluli. Krasniqi, duke i uruar mirëseardhje Arbër Behlulit, ka thënë se ai do të jetë kandidat i PDK-së për deputet. "Me një master në politikë e Bashkimin Evropian, Arbëri ka ndërnuar karrierë të suksesshme edhe si

ligjërues universitar, edhe si zyrtar i lartë në institucionet tona shtetërore. Tani ai është gati të marrë mbi vete një sfidë të re, të formësojë të ardhmen e Kosovës nga brenda Kuvendit. Ekspertiza, vizioni dhe përkushtimi i palëkundur i Arbërit ndaj shtetit dhe qytetarëve tanë, e bëjnë atë një zgjedhje të jashtëzakonshme për këtë rol", është shprehur Krasniqi. Behluli është zotuar se si deputet do të angazhohet për të lidhur brezat, duke siguruar që secili qytetar të ketë një zë

në ndërtimin e një Kosove më të mirë për të gjithë. "Çdo hap që kam bërë deri sot, nga rritja në një shtëpi ku atdheadashuria ka qenë gjithmonë vlerë e pazëvendësueshme e deri te shërbimi në institucionet e vendit tonë, më ka përgatitur për këtë moment. Me besimin tuaj, si deputet i Kuvendit të Kosovës, qëllimi im është ta sjell përvojën shumëvjeçare në krijimin e politikave që adresojnë sfidat reale të shtetit tonë, posaçërisht në diplomaci", ka thënë Arbër Behluli.

Emërimi i gruas së Aliut dhe nipit të Bislimit në bord të KOSTT-it, KDI: Shembull flagrant i nepotizmit

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shprehur shqetësim të thellë për zhvillimet në seancën e së enjtes të Kuvendit të Kosovës, ku vendimet e marra nga deputetët e shumicës parlamentare paraqesin shkelje të vlerave të qeverisjes së mirë, ndërkohë që përforcojnë elementet e korrupsionit dhe kapjes së institucioneve. "Së pari, emërimi i familjarëve të ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe zëvendëskryeministrit të parë, si anëtarë të Bordit të

drejtorëve të ndërmarrjes publike, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), paraqet një shembull flagrant të nepotizmit dhe konfliktit të interesit. Ky vendim përveç se cenon integritetin e institucioneve publike, zhvlerëson edhe premtimet dhe angazhimet e partisë në pushtet për institucione të pavarura. Për më keq, kjo vendimmarrje është në funksion të përdorimit të institucioneve për interesa private dhe politike të individëve të lidhur me pushtetin", thuhet në reagimin e KDI-së. Sipas KDI-së, së dyti, shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për Byronë Shtetërore për



Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme në të dy leximet brenda një periudhe të shkurtër kohore është një tjetër goditje për proceset demokratike

parlamentare. "Ky projektligj, i proklamuar si ndër më të rëndësishmit në luftën kundër korrupsionit, nuk do të duhej të miratohej pa konsultime publike, pa debat parlamentar

dhe pa përfshirjen e publikut. Ky nxitim në miratimin e tij, lë të kuptohet se projektligji po përdoret për qëllime elektorale, në vend që të shërbejë si mekanizëm kundër pasurimit të paligjshëm të zyrtarëve publik. Këto zhvillime janë tregues të një tendence shqetësuese për të dobësuar shtetin e së drejtës dhe për të favorizuar interesat e ngushta politike të partisë në pushtet. Kuvendi i Kosovës, në vend që të jetë gardian i përpjekjeve në luftën kundër korrupsionit, po keqpërdoret nga shumica parlamentare për motive elektorale, duke kompromentuar kështu integritetin institucional", thuhet në reagimin e KDI-së.

Shërbimi Korrektues i Kosovës pranohet në rrjetin Evropian të Burgjeve EuroPris

Prishtinë, 5 dhjetor - Një hap historik dhe arritje e jashtëzakonshme për sistemin korrektues të Kosovës: Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) zyrtarisht është pranuar anëtar i rrjetit prestigjioz evropian të burgjeve EuroPris. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ismail Dibrani, ka

pranuar letrën zyrtare të konfirmimit për anëtarësimin. Ky vendim shënon një pikë kthese për integrimin ndërkombëtar të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke përforcuar pozicionin e tij si një institucion modern dhe i përkushtuar për standardet evropiane në sistemin e drejtësisë dhe atë korrektues. EuroPris, si një platformë unike

që lidh institucionet e burgjeve dhe atyre sprovuese në të gjithë Evropën, promovon standarde të larta, transparencë dhe zhvillim të qëndrueshëm. Përmes këtij rrjeti Shërbimi Korrektues i Kosovës do të kontribuojë në ndarjen e përvojave dhe mësimave të veta, duke përfutur gjithashtu nga praktikat më të mira të vendeve anëtare.





Specialja vazhdon gjahun ndaj UÇK-së

- Gjykata Speciale arreston Isni Kilajn, Fadil Fazliun dhe Bashkim Smakajn

Gjykata Speciale ka arrestuar të enjten ish-kryetarin e Malishevës, Isni Kilajn, vëllanë e dy dëshmorëve, Fadil Fazliun dhe ish-drejtorin e AKI-së, Bashkim Smakajn. Po ashtu, Specialja ka bastisur shtëpinë e ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi. Ndaj këtyre arrestimeve kanë reaguar familjarët, përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe të partive politike. Ata e kanë akuzuar Specialen së është duke e vazhduar gjahun ndaj UÇK-së dhe njerëzve të saj

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Me urdhër të Gjykatës Speciale në Hagë janë arrestuar të enjten ish-kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, vëllai i dy dëshmorëve të kombit, Fadil Fazliu dhe ish-drejtori i AKI-së, Bashkim Smakaj. Po ashtu, Specialja ka bastisur shtëpinë e ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi.

Lidhur me arrestimet ka reaguar Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS). Një njoftim për medie, kjo zyrë ka bërë me dije se kanë kryer operacione në vazhdimësi në Kosovë në një proces hetimor që përqendrohet në vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Sipas këtij njoftimi, operacionet e ZPS-së janë autorizuar nga ana gjyqësore prej Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) dhe janë

mbështetur nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

"Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) po kryen operacione në vazhdimësi në Kosovë në një proces hetimor që përqendrohet në vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Operacionet e ZPS-së janë autorizuar nga ana gjyqësore prej Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) dhe janë mbështetur nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX)", ka njoftuar ZPS-ja.

Klinaku: Gjykata Speciale vazhdon gjahun ndaj UÇK-së

Arrestimet dhe bastisjet nga ana e Zyrës së Prokurorit të

Specializuar (ZPS) janë kritikuar ashpër nga familjarët e të arrestuarve, përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta, shoqëria civile dhe përfaqësuesit e partive politike.

Ushtruesi i detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se kjo gjykatë po vazhdon gjahun ndaj UÇK-së dhe luftëtarëve të lirisë. Në media u dha lajmi për arrestimin e Isni Kilajt e Bashkim Smakajt por, sipas informatave që po më vijnë, është arrestuar edhe Fadil Fazliu, vëllai i dëshmorëve Fahri e Bahri Fazliu", ka shkruar Kinaku në "Facebook". Ndërsa djali i Fadil Fazliut, Fahriu, ka treguar se si ka ndodhur arrestimi i babit të tij, i cili është vëllai i dëshmorëve, Fahri e Bahri Fazliut. Fahriu, i

cili mban emrin e xhaxhait të tij, ka thënë se është krenar me babanë, i cili ka qenë luftëtar i UÇK-së. "Sot, paradite rreth orës 8:00 të mëngjesit para banesës së tij kanë arrestuar babain tim, Fadil Fazliun, luftëtarin e UÇK-së, vëllain e dy heronjve të kombit, Fahri e Bahri Fazliu. Me urdhër të Dhomave të Specializuara të Hagës është arrestuar dhe pritët të dërgohet për në Hagë. Ballëhapur, kokëllart dhe gjithmonë krenar me të kaluarën tonë të lavdishme! Krenar me ty bablok!", ka shkruar Fazliu në "Facebook".

Murati: Një gjykatë e krijuar mbi të pavërtetën dhe padrejtësinë nuk mund të pritët të prodhojë drejtësi

Edhe kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka reaguar për arrestimin e Fadil Fazliut nga Gjykata Speciale. Ai ka shkruar në "Facebook" se një gjykatë e krijuar mbi të pavërtetën dhe padrejtësinë nuk mund të pritët të prodhojë drejtësi. Murati ka thënë se shumë përcudnime të realitet të së kaluarës ka prodhuar kjo gjykatë e shumë të tjera mund

të prodhojë.

"Një gjykatë e krijuar mbi të pavërtetën dhe padrejtësinë, nuk mund të pritët të prodhojë drejtësi. Për më tepër ajo zhytet çdoherë thellë e më thellë në realizimin e padrejtësisë. Shumë përcudnime të realitet të së kaluarës ka prodhuar kjo gjykatë e shumë të tjera mund të prodhojë. Sot qenka arrestuar Fadil Fazliu miku, shoku e bashkëveprimtari im në LKÇK, UÇK e LB, vëllai i dy dëshmorëve Fahri e Bahri Fazliu por edhe bashkëshorti, babai, gjyshi, vëllai e njeriu i mrekullueshëm. Për një gjë jam i sigurt, edhe këtë furtunë të jetës ai do ta tejkalojë dhe do të dalë faqebardhë", ka shkruar Murati.

Berisha: Specialja është një monstrum politik, do të dështojë misioni i saj

Ish-eprori i UÇK-së, Zafir Berisha, ka kritikuar aksionet e Gjykatës Speciale në Kosovë, ku janë arrestuar disa persona. Ai e ka vlerësuar Gjykatën Speciale monstrum politik, e cila po mundohet ta barazojë luftën e UÇK-së me luftën gjenocidale të Serbisë. Berisha ka shkruar në

REAGIM I KMDLNJ-së

Aktiviteti i shtuar i Gjykatës Speciale para zgjedhjeve në Kosovë

Sipas informatave të KMDLNJ-së, fallangat e Gjykatës Speciale në mëngjesin e së të enjtes, deri në këto çaste arrestuan Isni Kilajn, Bashkim Smakajn, Fadil Fazliun dhe Hajredin Kuçin (janë duke bastisur shtëpinë). Deri më tani nuk ka asnjë informatë për shkaqet e arrestimit, as nga Gjykata Speciale Raciste dhe as nga "themeluesit e kësaj gjykate - Kuvendi i Kosovës" e as nga MD-së që ia mbanë zhagun kësaj gjykate qoftë duke e pakësuar mbrojtjen efektive përmes shkurtimit të fondeve, qoftë përmes takimeve konfidenciale me Baba Vangën - Ekaterina Trandafilovën, kryetare e Dhomave Speciale kundër UÇK-së dhe kundër luftës. Ndonëse, së paku deklarativisht thuhet se në kuadër të kësaj arkitekture juridike, ZPS dhe DHS kompetencat janë të ndara, në praktikë, gjatë gjyqimeve nuk dihet kush është prokuror dhe kush është gjykatës pasi kompetencat që ua njeh ligji i

kanë ngatërruar duke i keqpërdorur skajshmërisht në dëm të të akuzuarve e që është në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria duke pamundësuar një gjykim të drejtë, fer, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht nga politika dhe grupet e interesit. Sidomos kohëve të fundit kemi një agresion joparimor dhe të bashkërenduar të ZPS dhe DHS kundër të drejtave për një gjykim të drejtë ndaj ish udhëheqësve më të lartë politikë dhe ushtarak të Kosovës për çka Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe avokatët e tyre iu drejtuan Trupit Gjyqësor për shkak të anshmërisë flagrante të tyre për llogari dhe dobi të ZPS-së dhe me përpjekje për të dëmtuar të akuzuarit duke bërë presion te dëshmitarë me pyetje sugjестive. Kjo nuk ka ndodhë në asnjë rast tjetër e as në Tribunalin për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë në Hagë. KMDLNj nuk pret korrektësi



nga Gjykata Speciale sepse askujt nuk i jep llogari për këto shkelje flagrante, është krejtësisht jotransparente duke dhunuar brutalisht parimin e publicitetit si njëri ndër shtyllat kryesore që garanton një gjykim të pavarur dhe të drejtë. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, oportunistë dhe të papërgjegjshëm që janë, nuk kanë guxim, as qytetar e as personal që të mbrojnë interesin e qytetarëve të saj që po mbahen peng në Hagë, jo duke ndërhyrë në procesin gjyqësor por duke kërkuar që të

respektohen të drejtat e njeriut. Këtë nuk e kanë bërë asnjëherë duke u bërë hallkë e zinxhirit të shkelësve të drejtave të njeriut. Ky proces nuk monitorohet nga askush dhe të ashtuquajturit monitorues, vetëm përshkruajnë gjykimin. Monitorimi korrekt dhe profesional para se të merret me pasojat, duhet të ketë mision parandalues përmes shkeljeve të identifikuar dhe rekomandimeve. Intensifikimi i aktiviteteve represive të Gjykatës Speciale para zgjedhjeve të përgjithshme në

Kosovë tregon qartë përpjekjen e saj për të ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve duke arrestuar persona vetëm nga krahu i luftës. Edhe fillimi i arrestimeve ishte puro politik, presidenti Thaçi u arrestua para se të shkonte në Uashington në takim me presidentin Trump për ta nënshkruar një Marrëveshje ekonomike. Deputetët e ardhshëm të Kuvendit të Kosovës, KMDLNj shpreson të jenë më të ndërgjegjshëm dhe më të përgjegjshëm duhet të diskutojnë për Gjykatën Speciale pasi thuhet se janë themelues të saj dhe se kjo gjykatë është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, në të kundërtën nëse Gjykata Speciale vazhdon me këtë injorim të turpshëm dhe shkelje të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria, atëherë, me një vendim të Kuvendit kjo gjykatë duhet të shpërbëhet. KMDLNj vlerëson se kjo gjykatë ka tejkaluar mandatin për çka është themeluar.



"Facebook" se Specialja do të dështojë në misionin e saj. "Në kohën kur po shihet hapur se po dështon Gjykata e Hagës si projekt serbo-rusë dhe i argatëve të tyre në Kosovë, sot ajo paska ndërmarrë një aksion tjetër arrestimesh në Kosovë, për me arsyetuar shpenzimet milionëshe që vijnë nga taksat e evropianëve. Ky mostrum politik i cili për qëllim ka barazimin e luftës çlirimtare të UÇK-së me luftën gjenocidale të Serbisë, do të dështoj, pavarësisht vuajtjeve që po ju shkakton bashkëluftëtarëve tanë dhe

qytetarëve të Kosovës", ka shkruar Berisha.

Behramaj: Një ditë pasi Thaçi u ngrit në këmbë kundër padrejtësisë në Hagë, Specialja filloi arrestimet në Prishtinë

Edhe ish-këshilltari i Hashim Thaçit, Adil Behramaj, ka reaguar në "Facebook" për arrestimet nga Specialja në Prishtinë, duke thënë se ato kanë ndodhur një ditë pasi ish-presidenti është ngritur në

këmbë kundër padrejtësisë. "Një ditë pasi Hashim Thaçi u ngrit në këmbë kundër padrejtësisë në Hagë, menjëherë në Prishtinë filloi arrestimet Zyra e Prokurorit të Specializuar. Ky është një persekutim klasik ndaj njerëzve që në formë direkte apo indirekte kanë lidhje me UÇK-në dhe krerët e saj në Hagë. Bashkim Smakaj është ish-ushtar i UÇK-së dhe një hero i heshtur i shtetit të Kosovës. Sot, Prokuroria e Gjykatës Speciale është shndërruar në Ndërmarrje të Përbashkët Kriminale dhe jo të

arrestuarit e saj në Hagë!", ka shkruar Behramaj. Kurse ish-këshilltari tjetër i Hashim Thaçit, Artan Behrami, ka thënë se arrestimet e Speciales dëshmojnë fundin e drejtësisë ndërkombëtare. "Një gjykatë e tërbuar, që sjell frikë, panik me çdo kusht po mundohet të na poshtërojë. Arrestimi i Bashkim Smakajt është e paprecedent. Në Hagë tashmë është institucioni i presidentit, kryeministrit, kryeparlamentarit, ministrit të Drejtësisë, AKI-së. Krejt shteti i Kosovës është në burg. Krejt

Kosova është në burg! Stop persekutimit, stop përndjekjeve raciste!", ka shkruar Behrami në "Facebook". Kujtojmë se në Hagë është duke u zhvilluar procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ata janë arrestuar nga Gjykata Speciale në nëntor të vitit 2020, ndërsa procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar në prill të vitit 2023. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat e ZPS-së.

Lufta hibride në Kosovë - e vërteta, trillime dhe spekulime



Shkruan: Hajdin ABAZI

Shpërthimi që u bë më 29 nëntor në komunën e Zubin Potokut plandosoi përtokë gjithçka që ishte pretenduar nga ana e kryeministrit për vendosjen e rendit dhe të sigurisë në veri: tregoi se aspak nuk ishte ashtu, dhe se propaganda nuk e mbulon dot realitetin e as e ndryshon.

Për dallim nga sulmi në Banjskë, i bërë nga forca të organizuara e të uniformuara, kjo në Varagë ishte ndryshe. Mund të kenë qenë të njëjtat forca, të uniformuara, ose krejt të tjera. Kjo nuk dihet. Derisa sulmi në Banjskë kishte për qëllim marrjen me anë të forcës ushtarake të veriut, shpërthimi në kanalën e Ibër-Lepencit në Varagë ishte akt sabotazhi, akt terrorist dhe që kishte për qëllim demonstrimin e një kapaciteti dëmshkaktues shumëdimensional.

Edhe më parë disa herë, por sidomos pas shpërthimit në Zubin Potok, policia bëri disa bastisje dhe gjeti një sasi të madhe të municionit, të uniformave dhe e mjeteve të tjera. Këto dëshmojnë se në veri jo vetëm nuk ka siguri, por krejt e kundërta është: se aty janë bërë përgatitje afatgjatë, të planifikuara dhe tash vihen në veprim sipas një strategjie të caktuar, për të shkaktuar pasiguri, tension dhe konflikte. Kryeministri doli se ka gënjer publikisht për gjendjen në veri. Kryeministrat para tij, të paktën këtë nuk e kanë bërë.

Shpërthimi i kanalit të ujit në veri, duket si i sinkronizuar me tensionet një ditë më parë, më 28 nëntor, në Maqedoni të Veriut kur u hoq flamuri kombëtar atje dhe ndaj kësaj reagoi popullsia shqiptare atje.

Ditë më parë erdhën edhe ca ushtarakë malazez në Kosovë me veturë ku ishte regjistrimi "Kosova është Serbi".

Kjo tablo, nxjerr në shesh se Serbia ndjek një strategji destabilizimi, e mundet që forca të ndryshme ruso-kineze në Serbi, të jenë shtytës të këtyre veprimeve nga më të ndryshmet, të sinkronizuara dhe të koordinuara, që ndryshe quhen "luftë hibride".

*

Lufta hibride është një term i ri i cili u fut në përdorim nga Frank G. Hoffman në studimin e tij "Konflikti në shekullin e 21-të: Shfaqja e luftës hibride", botuar në dhjetor 2007. Koncepti është shumë i gjerë dhe përfshin thuaja të gjitha llojet e luftëra, të gërshetuara, si luftën politike, luftën konvencionale, luftën e parregullt, luftën kibernetike, lajmet e rreme, diplomacia, ligji, ndryshimi i regjimit dhe ndërhyrjet e huaja zgjedhore etj.

Ç'është e vërteta, luftëra të kombinuara, në shumë aspekte ka pasur thuaja gjithmonë, por koncepti referon te kushtet moderne të zhvillimit të luftës kur ajo bëhet edhe pa u deklaruar si luftë. Pra jo si luftë e hapur, p.sh. sikurse është aktualisht lufta ruso-ukrainase. Një luftë e kamufluar, e fshehtë, tinëzare, por që shkakton dëme të pallogaritshme. Çka është më interesantja, mbeten të papërcaktuar aktorët e vërtetë të luftës hibride dhe duhet shumë kohë të konstatohet nëse njëmend është e tillë apo jo.

Mundësit teknologjike kanë tejkaluar kufijtë shtetërorë, i

kanë ngushtuar hapësirat gjeografike dhe i kanë bërë thuaja të gjitha caqet të arrira, pa shfaqjen direkte të agresorit, dhe shpesh edhe me vështirësi konstatimin e origjinës së sulmit. Kjo e bën të rrezikshme e të frikshme këtë lloj lufte, e cila, nuk përjashton asgjë dhe përfshin gjithçka. Edhe më herët, po sidomos nga lufta ruso-ukrainase lufta hibride u bë trend dhe një koncept me përdorim të gjerë, kur përdoret herë me vend e herë pa vend, si me qëllim për të detektuar të vërtetën e herë për të stisur një të vërtetë inekzistente, armiq dhe lloj lufte që në fakt nuk bëhet, por që në kuadër të konceptit mund t'i atribuohet karakteri i luftës hibride.

*

Në Kosovë termi "luftë hibride" u përdor nga pushteti, konkretisht nga kryeministri Kurti. Është për t'u vënë re, se ajo u përdor në kontekstin e brendshëm, dhe sidomos sivjet, pasi u bë e qartë se do të mbahen zgjedhjet parlamentare më 9 shkurt 2025. Luftë hibride quhet çdo veprim që bie ndesh me LVV-në dhe politikën e pushtetit, dhe nga kushdo që kritikohet, qëndrimet kundër, mospajtimet dhe kundërshtimet mund të shfaqen.

Për shembull, kur prokuroria nuk silltet si levë e qeverisë dhe e LVV-së, kryeministri e quajti se po bën lufta hibride kundër politikave të tija. Kur mediat i zbulojnë skandale qeverisë, ato etiketohen se po bëjnë luftë hibride ndaj qeverisë dhe Kurtit, e në shënjestër janë vënë të gjitha mediat, por veçmas Gazeta

Nacionale, Portali Periskopi, e pjesërisht edhe Gazeta Express. E pra, një kryeministër i interesuar për qeverisje të mire do të duhej t'u shprehte mirënjohje mediave kritike për kontributin në zbulimin e aferave korruptive, nepotiste e abuzive, sepse kështu ato ndihmojnë drejtësinë për t'i ngulfatur këto veprime minuese të shtetit ligjor që po mëtojmë ta bëjmë. Me këtë, sikur po ju kërkon mediave një aleancë: na lini të qetë të abuzojmë me pushtetin, përndryshe ju shpallim armiq. Kurse partitë opozitare, ato tashmë Kurti, Qeveria dhe LVV-ja i kanë targetuar si forca që bëjnë luftë hibride, kundër politikës së Kurtit. Epo, zoti kryeministër, përkund në botë, opozita nuk është për t'i mbajtur ison, por për ta kontrolluar në mënyrë demokratike e parlamentare, për ta kritikuar dhe për t'i adresuar fenomenet e dëmshme. E pikërisht këtë nuk e toleron dot qeveria Kurti, pasi që po i nxjerrin skandal pas skandali, po tregojnë se ai jo vetëm nuk qeveris më ndryshe nga pararendësit e tij, por madje edhe shumë më keq, pasi që e ka legalizuar nepotizmin, korrupsionin dhe abuzimet - kjo me vetë faktin se nuk distancohet dhe nuk i dënon asnjë nga këto vepra të kryera, kur kryesit i përkasin pushtetit të tij e sidomos jo partisë së tij.

*

Për ta paraqitur gjendjen si kaotike dhe tepër të rrezikshme, Kurti e përdori terminologjinë në trend të luftës hibride, për të selektuar

forcat që nuk pajtohen me politikën e tij, me mënyrën e qeverisjes dhe që opinionit po i tregojnë se qeverisja e Kurtit nuk është e tillë sikurse po e paraqet pushteti. Dhe sigurisht, për besimtarët e tij të verbër, kjo është një gjuhë gjeniale e "udhëheqësit suprem".

Kurti dhe vartësi i tij Murati, ministri i financave, gjithëherë kanë manipuluar me statistika, dhe ndonëse kanë dalë ekspertë vendor që i kanë demaskuar, madje edhe kur kanë dalë institucione ndërkombëtare, ata nuk kanë pranuar asnjëherë se janë lajthitur, ose se kanë pasur të dhëna të gabuara, por e kanë kaluar në heshtje.

Heshtja, hedhja në harresë e manipulimet me statistika, me akuza e me etiketime, është shndërruar në filozofi politike të Kurtit, për t'iu shmangur së vërtetës, për ta inkurajuar trendin e gabuar, abuzivitetin që të vazhdojnë, pasi që kryeministri po i toleron dhe i ka shndërruar në aletë të qeverisjes.

Kjo filozofi e mbrapshtë nuk është shpikur nga Kurti. Ajo ka qenë konstante e regjimeve totalitare dhe, dihet: fundi i saj është i hidhur; kur të kuptohet e vërteta, shumë ithtarë e besimtarë do të zhgënjehen e do të tronditen, atëherë braktisja do të jetë masive.

*

Sa herë që Kurti është ndodhur para ndonjë vështirësie nuk ka hezituar të manipulojë me të kaluarën. Ai për dy dekada ka pohuar se asgjë nuk është ndërtuar në Kosovë, por kur policia kryen aksione efektive - mburret me të; e pra, kjo polici

ka kryer veprime të tilla edhe më parë, dhe ajo është ndërtuar pikërisht gjatë kohës kur ai thoshte se asgjë nuk është ndërtuar e hairit në vend. Derisa tash mburret me policinë, heziton t'ua bëjë pagat të dinjitetshme!

Sidomos target e ka vazhdimisht goditjen e ish-kryeministrit dhe presidentit Hashim Thaçi. Për çdo dështim të tij, ngecje dhe mosecje përpara - fajet i ka Thaçi. Më 30 nëntor ai sërish e targetoi Thaçin. Ai është fajtor që nuk mund të dërgohet FSK-ja në veri, pasi që është pajtuar me KFOR-in që vetëm në koordinim me të, FSK-ja të mund të shkojë në veri. Dihet se FSK-ja asokohe kishte tjetër mision nga çfarë e ka tash. Megjithatë, atë që ishte një veprim i duhur, koordinimi me NATO-n, përmes KFOR-it, Kurti e quan të gabuar. Jo se nuk e di që NATO, d.m.th. KFOR-i e ka të drejtën e rezervuar për siguri në Kosovë, por shtret sikur nuk e di. Dhe me të drejtë një ish-bashkëluftëtar i Brigadës Atlantiku nga SHBA, i tha Kurtit - mos e përfill letrën e Thaçit, çoje FSK-në në veri!

Jo vetëm që nuk e bëri, por edhe më keq, u tregua se KFOR-i i kishte lejuar forcat e xhenios së FSK-së të shkonin në veri për sanimin e kanalit të shpërthyer nga akti terrorist, por që Kurti nuk e kishte dërguar. Atëherë, përse Kurti e akuzon Thaçin se ai po e pengon, kur e kishte rastin për ta dërguar FSK-në në veri, për të kryer një shërbim efikas në funksion të stabilitetit, por në vend të saj e dërgoi një kompani private!? Më së paku, kjo është mungesë e sinqeritetit dhe përpjekje për ta luajtur rolin e viktimës, se goja e kaluara po e pengon - epo kryeministër, duke mos qenë i pari, domosdo se do të kesh pasur një vazhdimësi nga e kaluara e kryeministrave, por tash, me mbi 50 % të forcës së pushtetit si asnjë kryeministër o pasluftës çlirimtare - e kishe shansin historik t'i bëje ndryshimet, por nuk i bëre dot. A do të kishte vallë pretext real më të favorshëm se sa dërgimi i xhenios së FSK-së për të treguar efikasitetin e vet në sanimin e gjendjes pas aktit terrorist në veri - dhe atë më bekimin e NATO-s përmes KFOR-it? Përse e humbe këtë shans, kryeministër, dhe përse po ankohesh se do ta kishe dërguar FSK në veri, sikur të mos ishte ajo letër e Thaçit e vitit 2013?

Ti që ke ardhur në pushtet duke akuzuar, sharë, fyer, etiketuar e propaganduar më shumë me fake facts se sa me të vërteta, ty nuk të ka hije dhe nuk të shkrepi, roli i viktimës, sepse e ke pushtetin me mbi 50%!

*

Nga tërë propaganda që e drejton Kurtit, është zor të dihet se çka është e vërtetë e çka spekulim, sepse mjeshtërisht i ngatërron ato, që të mos mund të dallohen. Për shembull, çfarë kanë mes vete kryeministri e presidentja? Ardha e zgjedhjeve dhe konstatimi se më bashkë nuk mund të fitojnë ashtu që ta bëjnë shumicën, është shkaku themelor që i ka minuar

raportet midis tyre. Përndryshe, në gjithçka, ata kanë qenë tandem. Kurrë presidentja nuk ka kundërshtuar për tri vjet, asgjë që ka bërë Kurti në minimin e partneritetit të Kosovës me SHBA. Dhe për gjithçka, ata janë njëloj përgjegjës. Prandaj, nëse Kurti e Gërvalla kanë luajtur bixhoz me partneritetin tonë me perëndimin, presidentja ka qenë pjesëmarrje në atë lojë dhe nuk ka as dhe një fjalë të vetme që të jetë distancuar (deri kur u kuptua se nuk e ka më përkrahjen e Kurtit dhe se Kurti po ia merr partinë). Në fakt, nëse asgjë tjetër, presidentja e tha një të vërtetë: presidentja, kryeministri e kryediplomatja ne bixhozin e tyre e kanë nxjerrë humbëse Kosovën në raport me perëndimin. Por këtë nuk e tha ajo nga se është parimore, sepse po të ishte e tillë, do ta kishte bërë që në fillim. Dhe sikur të dihej se së bashku do të mund të fitonin sërish, do të vazhdonte veprimi i Kurtit e heshtja e presidentes.

Presidentja gjithçka mundet të pranojë, port e mabetet pa pushtet - këtë jo, nuk mundet ta kapërdijë. Dhe ajo është treguar e zonja për të manovruar me objektiva arriviste. Këtë po e bënë edhe tash. Duket se ka një marrëveshje të heshtur midis LDK dhe presidentes, për rikthimin e kësaj. Por ky do të ishte një rikthim, me pasoja për LDK, e sidomos për leadershipin e Abdixhikut. LDK-ja sot duket unike sepse nuk e ka përçarësen presidente brenda saj. Po qe se rikthehet ajo, atëherë Abdixhiku duhet të bëhet gati për të pësuar si Fatmir Sejdiu dhe Isa Mustafa. Duket se lufta midis partnerëve qeverisës ishte bërë në heshtje. Kurti e ka përvetësua udhëheqjen e partisë që e krijoi presidentja dhe kjo tash ka mbet pa partinë e saj. Por o ëndërron votat e vitit 2021, të cilat nuk do t'i ketë më.

Presidentja po shpurdh aq sa po mundet, për të penguar Kurtin, LVV-ja dhe "tradhtarët" e saj. Kjo ndodhi me pretendimin që ambasadat të organizojnë zgjedhjet, gjë që e kundërshtoi njeriu i vendosur nga presidentja në krye të KQZ. Edhe përpjekjen që zgjedhjet të organizohen në një institucion fetar në SHBA, në xhami, as kjo nuk do të lejohet. Kështu, presidentja po e pengon vjedhjen industrial të votave, dhe këtu po, njëmend, po jep një kontribut të duhur. Madje edhe loja me "Darkën e lamës" nxjerri në pah përçarjen, kur ministri Peci e organizoi atë dhe aty, si një shenjhtë shkoi Kurtit, por që u shenjtëzua nga presidentja e cila jo vetëm nuk mori pjesë, por edhe tregoi se darka është një event që mbahet vetëm nën patronatin e presidentes, duke treguar kështu se ata po duan t'ia marrin kompetencat. Se lakmia e presidentes për pushtet e bëri që Kurtin nga dikur që e quante Chaves, t'i thurte elozhe, ishte e vetëkuptueshme se kushdo që ta privonte nga pushteti, ajo do t'ia kthente goditjet. Të thuash se ka luajtur bixhoz me

partnerët, domethënë në kurriz të Kosovës, është pohim se Kurti është Chavez i dikurshëm.

*

Kurti definitivisht po ndjehet i frikësuar përballë zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, ndaj dhe mori hov me organizimin e tubimeve parazgjedhore të organizuar nga ambasadat, duke e bërë diasporën sërish target. Por doli ambasadori gjerman dhe tregoi se ka limite për organizime të tilla në Gjermani, dhe ia ndali hovin, përndryshe do të qenë shndërruar ambasadat e konsullatit në filiale të LVV-së, të Kurtit e të Gërvallës.

LDK-ja është hedhur në luftë frontale kundër LVV-së, respektivisht kundër qeverisjes Kurti. Deputetja Hykmete Barjami dhe demanton, demaskon dhe po i nxjerrë në shesh gënjeshtër, mashtrimet dhe abuzimet e qeverisë Kurti. Duket se kjo linjë është e luftës agresive e ka ndritur LDK-në nga letargjia e saj, duke e bërë një parti që nuk e toleron mashtrimin publik.

PDK-ja po zhvillon një fushatë të ekuilibruar, të matur, aspak agresive, krejt kualitative. Ajo nuk e ka objektiv sulmin, por risinë. Ajo po paraqitet si një alternativë serioze, dhe Bedri Hamza është kandidati më kredibil i saj i mundshëm. Fushata e tij është fushatë konstruktive, premtuese dhe kualitative. Hamza ka përvojë në qeverisje dhe reputacion të mirë.

AAK-ja po ashtu ka bashkuar disa aleatë të vegjël, dhe po duket se forcat e bashkuara po japin efektin e vet: tubimet janë mirë të organizuara, fushata po zhvillohet me sens, po premtohen gjëra që njëmend duhet të bëhen. Të gjitha këto po e zhvillojnë para fushatën me një frymë perëndimore, duket sikur kanë marrë modelet e SHBA, dhe pjesëmarrja po duket premtuese.

Por ajo që ende nuk e kemi parë në Kosovë, është organizimi i LVV-së. Ajo që po paralajmëron Kurti, se opozita dhe mediat po bëjnë luftë hibride kundër LVV dhe qeverisjes së saj, është tregues se nuk ka reflektim, ndjehet në komoditet në abuzimet me pushtetin dhe se do të sulmojnë gjithçka. Sepse Kurti dhe LVV-ja, në kursin e tashëm politik, munden vetëm me agresivitet, me sulme, të paraqiten sikur po pengohen të bëjnë mrekullitë që do të mund t'i bënin (sikur të mos ishte opozita dhe sikur mediat të mos ua zbulonin skandalet), ashtu sikurse thoshin me vite e dekada të tëra diktatorët e regjimeve moniste për të cilët pengesë ishin armiqet e jashtëm e të brendshëm.

*

Shpërthimi që ndodhi në Varagë u duk sikur i shkoi për shtati Kurtit, sikur u përmbush profecia e tij për luftën hibride. Ndonëse britanikët kishin paralajmëruar rreth një muaj më parë dhe pra nuk ishte e papritur. Kurti menjëherë, natën vonë, mbajti një konferencë për media, ku

akuzoi drejtpërdrejtë Serbinë, opozitën dhe mediat, madje bëri thirrje që këto të mos lexoheshin e dëgjoheshin nga shtetasit tanë! Nuk vonoi dhe nga Serbia, drejtpërdrejt nga presidenti serb Vuçiq, erdhën kundër akuzave, duke aluduar se Kurti qëndron prapa shpërthimit. Dukej se po ngatërohej lëmshi pazgjidhshëm. Dhe me siguri, sikur të mbeteshin vetëm shtetarët e Kosovës e të Serbisë, fjalët do të ishin shndërruar në granata e predha oratorie, sa që konflikti do të vinte natyrshëm.

Ndërkohë që Kurti po merrej me stisjen e akuzave ndaj të gjithëve, Bedri Hamza, kandidati për kryeministër, shkoi atë mbrëmje në Varagë, në vendin e ngjapërrjes, kurse kryeministri shkoi të nesërmen dhe i shoqëruar me eskadronin e policisë!

Për fat, Ballkani Perëndimor është zonë e interesit perëndimor. Ndaj fillimisht ambasadori amerikan, pastaj ai britanik, gjerman, francez, NATO - KFOR-i, EULEX-i, deri te State Departamenti Amerikan dhe Bashkimi Evropian, reagon ndryshe nga rasti i Banjskës. Ata nuk drejtuan gishtin kah Serbia. Ishin të rezervuar. Dhe më 3 dhjetor në Bruksel, takimet e ndara me Kurtin e Vuçiqin, bënë që këta të dy të shushatnin dhe të ndalnin retorikën luftënxitëse. Gjithandëj u kërkua një hetim ndërkombëtar, i pavarur.

Presidentja e anuloi vizitën e saj në Brunei, për shkak të këtij akti terrorist. Në rrethanat të tjera, nuk do të duhej ta bënte. Por duke parë se Kurti po do ta nxjerrë nga loja, ajo e njeh mirë këtë rrezik, ndaj dhe vendosi të rrinte në vend.

*

Fitorja e presidentit Trump në SHBA i ka prishur kalkulimet e Kurtit dhe të LVV-së. Ai nuk do të jetë tolerant sa ishte presidenti Biden. Kurti do të ndodhet para alternativave "mere ose leje" dhe pasojat dihen. Edhe BE duket se është irrituar me pabesinë e Kurtit, me premtimet dhe mos përmbushjen e tyre. Kështu nuk bëhet dot politika, sepse nëse liderët nuk i përmbahen asaj që e pohojnë, atëherë nuk ka qëndrueshmëri. Gjithnjë mund të gjendet ndonjë arsye për ta ndryshuar një qëndrim. Dhe kur ato arsye janë triviale ose pa bazë të mirëfilltë, krijohet përshtypja e labilitetit dhe e pasigurisë në rrugëtimin politik. E tash Kurti po përballtet me lakadredhat e mashtrimet që i ka bërë në të kaluarën dhe nuk do të ketë më mirëkuptim, sepse as nuk është Putin i rus e as Xi kinez e Trumpi amerikan hiç se hiç që të mund t'i ndryshojë rregullat e lojës. E kam thënë edhe më parë, Kosova mundet të prosperojë dhe të forcohet ndërkombëtarisht vetëm duke u bashkërenduar deri në detaje me SHBA, Britaninë e Madhe dhe BE, më një fjalë me Perëndimin; ndryshe - Kosova degradohet në perceptimin ndërkombëtar. Se nuk kemi të bëjmë vetëm me Serbinë, por edhe me Rusinë, me Kinën e

me aleatët e tyre. Kosova duhet të tregohet konstruktive në planin e brendshëm, me problemet e mprehta sikurse është veriu dhe në planin diplomatik, dhe të ndjehet me fat që në këto rrethana të turbullta ndërkombëtare i ka në mbështetje vendet më të fuqishme të Perëndimit.

Presidentja dikur heshtake, pasi që Kurti është larguar thuaja pakthyeshem nga SHBA dhe Perëndimi, tash është bërë e zhurmshme në raport me qëndrimet ndaj Perëndimit. Ajo po e bën këtë, për të nxjerrë më në pah figurën antiperëndimore të Kurtit, për hesape të veta e jo për Kosovën. Dhe duhet kujtuar se presidentja i ka vënë njerëzit në krye të AKI-së, të Policisë dhe komandantin e FSK, dhe kjo i jep disa favore asaj kundër Kurtit. Por ajo e ka me hile edhe qëndrimin proamerikan dhe

properëndimore, sepse po ta kishte parim - nuk do të heshte në tri vitet e mjaltshme të bashkërendimit në gjithçka me Kurtin, dhe do të vazhdonte të rrinte po aq e heshtur, sikur t'i garantohej se do të zgjidhej sërish president. Kjo është ajo presidentja e cila, duke e mbajtur burrin e saj për dore sikur të shkonin në ndonjë sfilatë, kaloi përkaj personelit teknik që ishte në grevë, as pa e kthyer kokën kah ato, duke i injoruar totalisht gratë që ishin në grevë nga halli. Krejt pohimet e saj për angazhim për gratë, për barazi, për avancim grash e të këtilla, u shembën atë ditë.

Presidentja është një njeri që kurrë asgjë nuk ka dhënë as ajo e as burri i saj për Kosovën, vetëm kanë marrë prej saj, por që, për shkak të veprimeve abuzive të qeverisë Kurti, ajo ka mbetur nën hijen e tyre. Ka dhe më tepër, sigurisht por, mbase, ndonjëherë tjetër. Lufta e presidentes me kryeministrin nuk është luftë për parime, për ligjshmëri e për demokraci është, thjesht, luftë midis gladiatorësh për pushtet, që kur shohin se e humbin atë, nuk kursejnë asgjë.

*

Kjo është një tablo e luftës hibride në Kosovë. Diçka është e vërtetë, diçka krejt trillim, shume spekulime, shumë të pavërteta, gënjeshtër, fshehje faktesh. Fat, shumë fat, që Kosova është në zonën e interesit të Perëndimit, të SHBA-BE, që po na mbrojnë nga armiqet realë të jashtëm, por edhe nga vetvetja, nga destruktiviteti i politikanëve vendorë, destruktiviteti i cili e ka dëmtuar Kosovën pallogaritshëm.

Elektrizimi proaelektoral është vetëm ngrohje për fushatat elektorale. Atëherë, do të shpërthejë kanalizimi, jo kanali i Varagës, po kanalizimi politik, sa që duket se të gjithë do të portretizohen si armiq, pro serb dhe anti-Kosovë. E kjo, realisht, është një aspekt i luftës hibride, kur degradohet gjithçka, mbillen dyshime vend e pavend, dhe kur krijohet një atmosferë mosbesimi thuaja total. US, please stay with us!

Uji në kufirin e tensionuar: A mund t'ia ndërrojë Serbia kahun Ibrit?

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ndonëse teknikisht i mundur, ndryshimi i kahut të lumit Ibër nga Serbia në dem të Kosovës do të shkaktojë shkelje të ligjit dhe konventave ndërkombëtare, thonë ekspertët. Megjithatë, sipas tyre, nevojiten garanci për sigurinë e kësaj rrjedhe, si dhe alternativa për ta shkurtuar varësinë e madhe nga ky damar i rrezikuar.

Shpërthimi që dëmtoi kanalën e ujit Ibër-Lepenc në veri të Kosovës, për të cilin autoritetet e Kosovës fajësojnë Serbinë, nisi një diskutim për sigurinë e këtij furnizimi ujor vital për jetën e shumë kosovarëve.

Sulmi mund ta rrezikonte edhe furnizimin me energji në Kosovë, për ç'shkak Qeveria e Kosovës mori vendim që të gjendet zgjidhje alternative për furnizimin me ujë të termocentraleve.

Për incidentin e 29 nëntorit, si pasojë e të cilit nga ajo ditë po vazhdojnë shkurtimet e ujit të pijshëm për një pjesë të Kosovës, pati disa të arrestuar dhe bastisje në veri të vendit.

Në anën tjetër, Serbia e mohoi përfshirjen dhe tha se do të bëjë edhe vetë hetime për ngjarjen.

Në një deklaratë pas shpërthimit, presidenti serb Aleksandër Vuçiq tha se që nga viti 1985 "ekziston një ide për ta ndryshuar rrjedhën e lumit Ibër për nevojat e popullatës në qytezat afër liqenit, që si pasojë do ta thante Ujmanin, nga i cili furnizohet Kosova. Sipas tij, kjo mund të ndodhë "me një vendim të qeverisë serbe". Megjithatë, ai shtoi se vetë ka qenë kundër kësaj ideje kur iu propozua, madje edhe kur ishte kryeministër, duke theksuar se nuk dëshironte që "natyra të përdoret për nevoja politike".

Sipas zëdhënësit të Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, "Serbia nuk ka të drejtë as të shfrytëzohet lumit Ibër në një mënyrë që e dëmtin rëndë Kosovën, lëre më ta shkaktojë qëllimisht këtë dem përmes ndryshimit të rrjedhës".

Sipas Kryeziut, adresimi i Vuçiqit ku është përmendur ideja e ndërrimit të rrjedhës së lumit "është edhe një indikacion që ata janë prapa sulmit në Varragë të Zubin Potokut", në veriun e banuar me shumicë serbe. "Pra, në vend se ta devijojnë rrjedhën e Ibrit, ia vunë eksplozivin kanalit Ibër-Lepenc", thotë Kryeziu.

Lumi Ibër, i gjatë rreth 270 kilometra, buron në Mal të Zi, kalon nëpër territorin e Serbisë, hyn në Kosovë me një gjatësi të shtratit prej 82 kilometrash dhe më pas kthehet në Serbi. Ibrit më pas mbush liqenin artificial të Ujmanit, i cili, po ashtu, shtrihet në kufirin Kosovë - Serbi, me dy të tretat e tij në anën e Kosovës. Ai furnizon me ujë shtatë komuna, përdoret për ujitje si dhe ftohjen e termocentraleve në Obiliq, që

prodhojnë shumicën e energjisë elektrike në vend. Sipas Qeverisë së Kosovës, nëse sulmi në kanalën e Ibër-Lepencit do ta arrinte qëllimin e tij, "pasojat do të ishin marramendëse" dhe në formë zinxhiri do të shkaktonin mungesë të ujit, të energjisë elektrike, ngrohjes e deri te telekomunikimi. "Ministrja e Ekonomisë (më 3 dhjetor) ka nënshkruar një vendim me të cilin obligon KEK-un, Ibër-Lepencin dhe Ujësllësin Prishtinë ta gjejnë zgjidhjen teknike alternative për furnizim të Termocentralit Kosova B me ujë, me qëllim të rritjes së sigurisë së furnizimit me ujë të termocentralit", thotë për Radion Evropë e Lirë, Përparim Kryeziu.

A e lejon ligji ndërkombëtar ndryshimin e rrjedhës së lumit?

Një nga instrumentet kyç botërore që ka rregulluar çështjen e ujërave ndërkufitare është Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 1997 "për përdorimin jo navigacional të ujërave ndërkombëtare".

Serbia është pjesë e kësaj konvente, ndërsa Kosova jo, meqë ende nuk është anëtare e OKB-së.

Ndër të tjera, Konventa e OKB-së parasheh se për ujërat ndërkufitare duhet të ndiqen "parimet e shfrytëzimit dhe pjesëmarrjes së drejtë dhe të arsyeshme".

Parime të tjera të konventës janë edhe "obligimi për të mos shkakuar dëm të rëndësishëm" dhe "obligimi i përgjithshëm për bashkëpunim". "Kjo konventë vlen për vendet në konflikt", thotë për Radion Evropë e Lirë, Miguel Borja Bernabé-Crespo, profesoreshë në Departamentin e Gjeografisë në Universitetin e Madridit.

Bernabé-Crespo është edhe president i "Grupit të Mendimit Gjeografik" të Shoqatës Spanjolle të Gjeografisë si dhe redaktor në revistën shkencore "Uji dhe Territori". Më 2019 ai kishte publikuar një studim në lidhje me menaxhimin e ujit në Liqenin e Ujmanit, i cili gjendet në zonë të kufirit të kontestuar. "Problemi kryesor në këtë rast është që kufiri ekziston vetëm nga pikëpamja e Kosovës pasi Serbia nuk e njeh pavarësinë e saj", thotë Bernabé-Crespo. "Por, edhe nëse nuk e njeh, (Kosova) përfaqëson një aktor me një qeveri të njohur nga shumë shtete të tjera, prandaj komuniteti ndërkombëtar mund të bëjë presion drejt një bashkëpunimi", shton ai. Sipas tij, në rast të një vendimi të Qeverisë së Serbisë për ndryshim të rrjedhës së lumit, Konventa e OKB-së obligon arsyetim të fortë për këtë. "Konventa parasheh që shtetet ta njoftojnë njëra-tjetrën



për çfarëdo mase që mund të afektojë secilin nga shtetet", thotë ai, duke shtuar se interesat humane si furnizimi me ujë dhe pasojat mjedisore, gjithashtu duhet pasur parasysh në këto raste.

Edhe sipas ekspertit të ujërave të Kosovës, Avdullah Nishori, një veprim i tillë i Qeverisë së Serbisë do të ishte thuajse i pamundur, madje edhe për shkaqe ekonomike. "Do të ishte një investim megaloman të provohet të ndërrohet (kahu) i Ibrit", thotë Nishori, i cili aktualisht është edhe anëtar i bordit të ndërmarrjes Ibër-Lepenci, që e menaxhon ujin e Ibrit dhe Ujmanin në Kosovë.

Sipas Nishorit, megjithatë, Kosova duhet të mendojë për resurse alternative dhe emergjente që shërbejnë për raste si ky i sulmit të fundit, por edhe "fatqësive natyrore që rrezikojnë furnizimin me ujë". Ai përmend se në të kaluarën janë bërë gabime duke u anashkaluar ide për diga apo akumulime ujore, që do të shërbenin për emergjencat.

Një e tillë ai thekson se ishte propozuar rreth vitit 2016 me një studim fizibiliteti të Bankës Botërore. Ky investim nuk u realizua asnjëherë. Sipas këtij projekti, diga do të ndërtohej në fshatin Mihalij të komunës së Vushtrrisë dhe do të mund të siguronte furnizim emergjent disaditor në rast të ndërprerjes së furnizimit nga kanali për çfarëdo arsye. "Kanë qenë të parapara rreth 20 milionë euro për përmirësim të infrastrukturës dhe në kuadër të kësaj edhe diga", tregon Nishori. Në studimin që e ka parë Radio Evropë e Lirë, ku ishte rekomanduar ndërtimi i kanalit, thuhet se për ndërtimin e tij nuk do të kishte nevojë për shpronësime pasi tokat përreth ishin kryesisht kullosa.

Ndonëse nuk e di me siguri arsyen e anulimit të projektit, sipas Nishorit, ai mund të jetë parë si i panevojshëm në atë kohë.

Menaxhmenti aktual i Ibër-Lepencit dhe ish-zyrtarët e tij, deri më tani, nuk u janë përgjigjur pyetjeve të Radios Evropë e Lirë në lidhje me këtë projekt dhe pse ishte anuluar. Ish-zyrtarë të kësaj ndërmarrjeje kanë deklaruar në medie lokale se "Projekti nuk i

ka arsyetuar investimet".

A ka mundësi Kosova të zhvillojë resurse të reja ujore?

Sipas të dhënave zyrtare, Kosova konsiderohet një vend "me stres ujor" për shkak të kapaciteteve jo të mjaftueshme të furnizimit me ujë.

Në Strategjinë e Kosovës për Ujërat për vitet 2023-2027, thuhet se, krahasuar me vendet në rajon si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Kosova ka më së paku resurse ujore për kokë banori. "Pozita gjeografike është e atillë që shumica e lumenjve ikin nga Kosova ose e përshkojnë shumë pak. Pastaj lumenjtë tanë janë sezonalë, gjatë dimrit kur kemi më pak nevojë - ka ujë, por gjatë verës kur kërkesat rriten, mund mos të kemi ujë", shpjegon Nishori. Sipas tij, investime në akumulime ujore të reja si zgjidhje afatgjatë, marrin kohë dhe kanë kosto. "Unë nuk jam i prirë të them se ka zgjidhje të shpejta, sepse zakonisht janë të këqija. Dhe nuk ka zgjidhje të lira, ngaqë duhet ndërtuar një infrastrukturë", tha ai.

Qeveria e Kosovës thotë për REL-in se ka projekte për ndërtimin e rreth tetë rezervuarëve të rinj të ujit që mund t'i rrisin kapacitetet e furnizimit me ujë për rreth 120 për qind të kapaciteteve aktuale, pa përfshirë Ujmanin. Ajo nuk bën të ditur kohën kur këto projekte mund të realizohen. "Këto projekte thelbësore janë pjesë e strategjisë për t'i përballuar sfidat klimatike, duke përfshirë thatësinë dhe përmbytjet, dhe për të garantuar furnizim të qëndrueshëm me ujë për të gjithë vendin", thekson Përparim Kryeziu, zëdhënësi i qeverisë.

Disa prej rezervuarëve të përmendur, përkatësisht ai në fshatin Firajë dhe Shtime, kanë qenë të paraparë edhe në një projekt që daton dekada më parë.

Infrastruktura e kanalit të Ibër-Lepencit, i cili nisi të ndërtohet në vitet '70 në Kosovë, kishte paraparë një strukturë të konsoliduar për t'i menaxhuar ujërat e dy lumenjve të Kosovës: Ibrit dhe Lepencit. Pjesa e Ibrit u krye dhe është

funksionale, ndërsa pjesa e Lepencit, lumë në juglindje të vendit, nuk u zhvillua asnjëherë deri më tani.

Sipas strategjisë të Kosovës për ujërat, kjo infrastrukturë do të mundësonte furnizim më të qëndrueshëm për nëntë komuna të tjera në lindje dhe në jug të Kosovës.

Ndërmarrja Ibër-Lepenci i tha Radios Evropë e Lirë se kohën e fundit është përgatitur projekti që përfshin ndërtimin e një pende në Firajë të komunës së Shtërpcës (Kosova qendrore) që do të mbushej nga lumi Lepenc. Në një pjesë të dytë të projektit, sipas tyre, parashihet ndërtimi i digës dhe liqenit akumulues në Shtime "i cili do të përdoret edhe për ujitje dhe prodhim të energjisë". Sipas ndërmarrjes, kjo fazë "është shumë më e shtrenjtë", megjithëse nuk ndau shifra apo edhe kohëzgjatjen e mundshme të projektit për asnjërin nga fazat.

Nishori thotë se në projektin fillestar për Ibër-Lepencin "kjo strukturë ka pasur të paraparë edhe një kanal për të shkuar në termocentralin Kosova B për të shërbyer si alternativë" por, sipas tij, investimi mund të vonohet për vite të tëra.

"Investime në infrastrukturë dhe riciklimin e ujit"

"Është gjithmonë ide e mirë të diversifikohen burimet e furnizimit të ujit. Së pari, për të mos u varur në masë të madhe nga burimet e përbashkëta ujore (me Serbinë)", thotë Bernabé-Crespo. Por, sipas tij, Kosova ka urgjencë edhe për përmirësimin e infrastrukturës ujore "për t'i evituar humbjet e ujit". Sipas të dhënave zyrtare, nëpër sistemet e ujësllësve në Kosovë, ka humbje të ujit në shkallë deri mbi 50 për qind, që përfshijnë humbjet fizike (rrjedhjet nga gypat) apo humbjet komerciale (gabimet në matje dhe lexim, vjedhjet etj.).

Në anën tjetër, sipas profesorit spanjoll, një tjetër zhvillim shqetësues janë ndryshimet klimatike që, po ashtu, "do ta zvogëlojnë disponueshmërinë e ujit për shkak të shpërndarjes më të pabarabartë të reshjeve". Sipas tij, është thelbësore të zhvillohen strategji që kanë të bëjnë me burimet e tjera ujore, si: ulja e ndotjes dhe përmirësimi i cilësisë së ujërave nëntokësore dhe zhvillimi i riciklimit të ujit.

"Për koston që ka, është më efektive sesa burimet e tjera të reja ujore", thotë ai.

Zëdhënësi i qeverisë thotë për REL-in se ekzekutivi ka paraparë projekte si rehabilitimi i rrjeteve të ujësllësit në Gjakovë, Gjilan, Ferizaj dhe Prizren, prej qindra miliona eurosh dhe "synojnë reduktimin e humbjeve të ujit, përmirësimin e cilësisë dhe ndarjen zonale të furnizimit".

KEK-u: Është ndalur njësitja B2, do të kryhet një kontroll teknik i pajisjeve

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Korporata Energetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se të enjten rreth orës 01:08 min është ndalur njësitja B2.

Në njoftim thuhet se gjatë kësaj ndalesë të shkurtër do të

kryhet një kontroll teknik i pajisjeve dhe eliminimi i defekteve (rrjedhjeve të ujit) të paraqitura në kaldajë. "Ky proces dhe sanimet e nevojshme janë planifikuar të përfundojnë nesër gjatë

ditës", thuhet në njoftimin e KEK.

KEK-u, gjithashtu, bën me dije se ka arritur ta sigurojë të gjithë energjinë e nominuar nga njësitja B2 për datën 05.12.2024. "Kjo ndalesë është

e nevojshme për të siguruar që njësitja të jetë në kushte optimale për prodhim dhe për ta garantuar vazhdimësinë dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike", thuhet në njoftimin e KEK-ut.



Bardhyl Mahmuti shpreh keqardhje për reagimin ndaj deklaratës së ish-presidentit Thaçi

Më në fund doli në shesh: Grupi Politik i kryesisë së Degës së LPK-së ka lëshuar komunikatat në emër të UÇK-së



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Gjatë tërë periudhës kur kam qenë anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, i cili ishte organ vendimmarrës i Degës së LPK-së Jashtë Vendi, u kam besuar thëniet e anëtarëve të kryesisë se komunikatat e UÇK-së ishin shkruar dhe shpërndarë nga Kosova. Ky qëndrim më ishte përforcuar pas Mbledhjes së Gjashtë të Përgjithshme të LPK-së Dega Jashtë Vendi, që u mbajt më 2 dhe 3 maj 1998, në Zell (rrethinë e Zyrihut në Zvicër), kur u zgjodh Këshilli i ri i Përgjithshëm, i cili në mbledhjen e mbajtur më 6 qershor 1998 në Vurzburg të Gjermanisë, zgjodhi Kryesinë e re: Bedri Islami (kryetar), Jashar Salihu dhe Bardhyl Mahmuti (nënkryetar), Sejdi Gega (përgjegjës financiar), Agush Buja (sekretar), Ali Ahmeti dhe Ibrahim Kelmendi anëtarë të kryesisë.

Me aq sa jam në dijeni, anëtarët e kryesisë së re të Këshillit të Përgjithshëm asnjëherë nuk kanë shkruar komunikata apo deklarata politike në emër të UÇK-së, sepse kemi qenë të bindur se një gjë e tillë duhej të bëhej nga njerëzit që ishin në Kosovë, të cilët ishin në dijeni të plotë të aksioneve që kryheshin, dhe të shmangej mundësia që të dilnim joseriozë nëse identifikoheshim burimi i shpërndarjes së njoftimeve të kësaj natyre nga jashtë Kosovës. Pikërisht për shkak të besimit që kisha krijuar se komunikatat dhe deklaratat, nëpërmjet të cilave fillimisht Shtabi Qendror, e më vonë Shtabi i Përgjithshëm, merrnin përsipër aksionet e UÇK-së, shkruheshin dhe shpërndaheshin nga Kosova, në muajin shkurt 2019 kam reaguar kundër ish-presidentit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, i cili pati deklaruar se "gjatë luftës dhe pas saj janë shkruar komunikata dhe deklarata edhe nga banhofet jashtë vendit".

Përkundër asaj se disa herë Ibrahim Kelmendi, unë dhe veprimtarë të tjerë e kemi aktualizuar publikisht çështjen e shkrimit të komunikatës numër 45, të datës 9 mars 1998, dhe të komunikatës numër 46, të datës 16 mars 1998, të lëshuara në emër

të Shtabit Qendror të UÇK-së, në të cilat nuk u shkrua asnjë fjalë e vetme për Epopenë e UÇK-së, rezistencën legjendare të familjes Jashari dhe krimin e gjenocidit në Likoshan, Qirez dhe Prekaz, asnjëherë nuk morëm përgjigje. Aktualizimi i kohëpaskohshëm i kësaj çështjeje bëri që një numër i bashkëveprimtarëve ta shprehnin mendimin e tyre se ndoshta lënia në heshtje e Epopesë së UÇK-së ka mundur të ndodhë për shkak të mungesës së informatave të sakta për atë që ndodhi në Prekaz.

Pretendimin se kjo heshtje ka mundur të ndodhë për shkak të mungesës së informatave, e kam hedhur poshtë për disa arsye:

- Krimi në fshatrat Likoshan dhe Qirez kishte karakteristika të një akti gjenocidal, ndërkaq përmasat e mobilizimit të forcave serbe në Drenicë ishin paralajmërim i qartë i fillimit të zbatimit të projektit të gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës. Pa prituri vendimin e kryesisë së Degës së LPK-së, kryesitë e nëndegëve të saj organizuan me dhjetëra tubime dhe protesta në Gjermani, në Zvicër, në Francë, në Britani të Madhe dhe në disa shtete të tjera të Evropës Perëndimore.

- Më 2 mars 1998, nëndega e LPK-së për Zvicër organizoi një protestë përpara selisë së Kombeve të Bashkuara në Gjenevë për të shprehur revoltën tonë dhe njëherësh të alarmonim institucionet ndërkombëtare për rrezikun që u kanoseshin shqiptarëve të Kosovës nga Serbia. Në konsultim me Jashar Salihun, Ramadan Avdiun, Bilall Sherifin dhe Agush Bujën vendosëm që, në të njëjtën kohë që përpara selisë së OKB-së protestonim mbi 10 mijë shqiptarë, të organizonim një konferencë me gazetarët e akredituar në selinë e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë. Në marrëveshje me veprimtarët e lartpërmendur, vendosëm që në këtë konferencë të shkonim vetëm unë dhe Jashar Salihu, Hero i Kombit, i cili në atë kohë ishte anëtar i Sektorit të Veçantë dhe përgjegjës i fondit "Vendlindja thërret";

- Në numrin e 5 marsit 1998 dhe të 12 marsit 1998, e përjavshmeja "Zëri i Kosovës", që ishte organ i LPK-së dhe e vetmja gazetë në gjuhën shqipe që përkrahte tërësisht luftën çlirimtare, i dha një hapësirë të konsiderueshme fillimit të zbatimit të gjenocidit të Serbisë në Kosovë dhe mobilizimit të shqiptarëve;

- Krimet monstruoze që kryen forcat serbe në Likoshan, Qirez dhe Prekaz, ku u vranë mbi 80

shqiptarë, zunë vend të rëndësishëm në mediet më prestigjioze botërore. Në këtë kontekst, më 9 mars 1998, në mbledhjen e mbajtur në Londër, Grupi i Kontaktit përpiloi Deklaratën për Kosovën. Në pikën 2 të kësaj deklaratë, Grupi i Kontaktit gjeti hapësirë për të shprehur brengosjen e thellë për vrasjen e së paku 80 personave dhe dënoi dhunën kundër protestuesve paqësorë, që ndodhi gjatë protestës së 2 marsit në Prishtinë;

- LPK-ja ishte e informuar për përmbajtjen e Deklaratës së Grupit të Kontaktit, ndaj së cilës reagoi. Në deklaratën që pretendohet se është lëshuar në Prishtinë, më 10 mars 1998, nuk u tha asnjë fjalë e vetme për krimet e gjenocidit që kishte kryer Serbia në Drenicë;

Përmendja e argumenteve të kësaj natyre bëhej për arsye se nuk kam qenë në dijeni se brenda kryesisë së moçme të Degës së LPK-së ishte caktuar Grupi Politik të cilit i ishte ngarkuar detyra të shkruanin komunikatat në emër të Shtabit Qendror të UÇK-së. Në mesin e reagimeve që ngjalli akademia për 30-vjetorin e UÇK-së me tendencën për ta shtrembëruar realitetin historik, në funksion të përvetësimit të rezultateve të luftës çlirimtare, ishte edhe reagimi i Muhamet Kelmendit, ish-nënkryetarit të organizatës. Në postimin e tij në

"Facebook", të titulluar "Reagim në fjalën e Emrush Xhemajlit në 30-vjetorin e emërimit të UÇK-së", ai pohoi se nga viti 1997, me detyrë të shkrimit të komunikatave ishin të ngarkuar anëtarët e Grupit Politik, në përbërje të së cilës ishte ai (Muhamet Kelmendi), Fazli Veliu dhe Emrush Xhemajli dhe ky grup ka shkruar komunikatat, së pak, deri në komunikatën 49 (që është lëshuar në emër të Shtabit të Përgjithshëm).

Një të dhënë shtesë dhe tepër të rëndësishme për të sqaruar të vërtetën rreth asaj nëse anëtarët e Grupit Politik kanë qenë në njohuri të ngjarjeve që u zhvilluan ato ditë në Drenicë, jep anëtarit tjetër i Grupit Politik, Emrush Xhemajli, në të ashtuquajturin "dokumentar-Rruga e çlirimit", të transmetuar në RTK, më 28 nëntor 2024.



Në minutat 23:40-24:30 të "dokumentarit" të lartpërmendur, Emrush Xhemajli pohoi publikisht se "kryesia e LPK-së kishte marrë një letër tepër të rëndësishme nga Adem Jashari, e shkruar me dorë, nga Hamëz Jashari", nëpërmjet së cilës i kishte njoftuar hollësisht për ngjarjet që janë zhvilluar nga momenti kur forcat serbe kanë sulmuar Abedin Rexhën, për rezistencën e tij e deri te dalja publike më 27 nëntor 1997.

Të jesh i njoftuar hollësisht për ngjarjet që i paraprinë asaj që


mori emrin "Epopeja e UÇK-së" dhe të lëshosh dy komunikata në emër të UÇK-së pa përmendur heroizmin e atyre që me sakrificën e përmasave mitike i dhanë shpirt luftës çlirimtare të popullit shqiptar, dëshmon për qasjen mospërfillëse që ka zbatuar Grupi Politik i kryesisë së Degës së LPK-së, Jashtë Vendi.

Fatmirësisht anëtarët e kryesive të nëndegëve të LPK-së dhe anëtarët e redaksisë së gazetës "Zëri i Kosovës" patën qëndrim të drejtë dhe e shpëtuan Lëvizjen Popullore të Kosovës nga turpi që do t'i binte për shkak të veprimeve të këtij "Grupi Politik". Nuk e di nga cili vend, ky Grup Politik i ka lëshuar komunikatat në emër të Shtabit Qendror (komunikatat nga numri 11 deri në komunikatën me numër 46) dhe në emër të Shtabit të Përgjithshëm (komunikatat me numër 47, 48 dhe 49), por, pasi dolën sheshit disa fakte që nuk i kam ditur, më vjen keq për reagimin tim ndaj deklaratës së ish-presidentit të Kosovës, z. Hashim Thaçi se "gjatë luftës dhe pas saj janë shkruar komunikata dhe deklarata edhe nga banhofet jashtë vendit". Sot asgjë nuk përjashtoj!

Të gjitha të dhënat e reja që kanë dalë në shesh "për 30-vjetorin e UÇK-së" do të përfshihen në ribotimin e librit "Ushtria Çlirimtare e Kosovës : në shënjestër të vazhdueshme".



Huazuar nga monografia LPK & UÇK, autorë Fazli Velia dhe Sejdi Gega.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Trajneri i Lilles: Zhegrova duhet të përmirësohet

LILLE, 5 DHJETOR - Trajneri i Lilles, Bruno Genesio, e ka lavdëruar sulmuesin Edon Zhegrova, mirëpo pret nga ky i fundit të përmirësohet edhe më shumë. Genesio për "Europe 1" ka treguar se pret nga Zhegrova të shkëlqejë në secilën ndeshje, ku

e tëra që i mungon është konsistenca. "Ai është lojtar i talentuar, i cili është në gjendje ta bëjë dallimin në çdo periudhë të ndeshjes. Kam marrëdhënie të mirë me të dhe mendon se mund të përmirësohet në vazhdimësinë e ndeshjeve të

mira. Duhet që të jetë i mirë në çdo ndeshje dhe mendon se mund të përmirësohet në këtë aspekt", ka thënë ai. "Është faktor sepse është në gjendje të shënojë gola të jashtëzakonshëm, ashtu siç ka bërë në kupat evropiane, sidomos në ato të 'play-off'-it.

Është i dashur për të gjithë dhe është integruar shumë mirë te skuadra e Lille", ka shtuar tekniku francez. Zhegrova mund të rikthehet te goli qysh të premten në përballjen që Lille e zhvillon ndaj Brest, në kuadër të Ligës 1.



FFK-ja ka proceduar në CAS ankesën ndaj vendimit për ndeshjen Rumani - Kosovë



PRISHTINË, 5 DHJETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka njoftuar se ka proceduar në CAS (Court of Arbitration of Sport) ankesën ndaj vendimit të UEFA-s në lidhje me ndeshjen Rumani - Kosovë. FFK-ja beson se do të ketë një vendim të drejtë nga CAS-i. "Federata e Futbollit e Kosovës njofton opinionin

publik se në afatin e përcaktuar kohor, ka proceduar në CAS (Court of Arbitration of Sport) ankesën ndaj vendimit të UEFA-s në lidhje me ndeshjen Rumani - Kosovë, të datës 15.11.2024. FFK-ja, përveç angazhimit të ekipit të vet ligjor, është në konsultim edhe me disa studio ligjore me përvojë të madhe me lëndët në CAS,

kryesisht nga Zvicra dhe Gjermania, për t'u përfaqësuar në mënyrën e vet më të mirë në këtë betejë ligjore në kërkim të së drejtës për federatën dhe ekipin tonë kombëtar. Federata e Futbollit e Kosovës shpreh besimin e plotë që CAS do të marrë vendim të drejtë e meritë", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Kosova U19 dhe U17 mësojnë kundërshtarët për kualifikimet 2025

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kosova U19 dhe Kosova U17 kanë mësuar kundërshtarët që do të përballen për kualifikimet që zhvillohen në vitin 2025. Kosova U17 me përzgjedhës Arbnor Morina, ka njohur kundërshtarët për kualifikueset e raundit të parë për Kampionatin Evropian "Estoni 2026".

Shorti i hedhur në selinë e UEFA-s e vendosi Kosovën në Grupin 6, së bashku me Austrinë, Irlandën dhe Ishujt Faroe.

Të gjitha ndeshjet e Grupit 6 të këtij mini-torneu do të luhen në Kosovë, datat e zhvillimit të këtij turneu do të caktohen së shpejti. Vendet e para dhe të dyta të çdo grupi

do të kualifikohen më tej në raundin e dytë të kualifikueseve. Kosova U19 me Adil Maliqin do të bëjë pjesë në Grupin e 12-të së bashku me Norvegjinë, Gjermaninë dhe Armeninë. Turneu kualifikues i kësaj grupmoshe do të mbahet në Norvegji më 8, 11 dhe 14 tetor 2025.



Debuton për Evertonin, Broja: Çast i veçantë për mua



LIVERPOOL, 5 DHJETOR - Gjashtë muaj pa prekur fushën me këmbë në një ndeshje zyrtare në Premierë Ligë ishin një përjetësi për Armando Brojën. Merr fund makthi për "bomberin" kuqezi, me Brojën që bëri debutimin zyrtar me fanellën e Evertonit në sfidën kundër Wolves (1-0). Broja u inkuadrua në minutën e 83-të pasi Evertoni kishte mbyllur llogaritë me "ujqërit" teksa kryesonte 4-0. Brojës i mjaftuan pak minuta në fushë

për të treguar të gjithë potencialin e tij shpërthyes. Në përfundim të ndeshjes, Broja mori duartrokitjen e tifozëve dhe të gjithë lojtarëve të Evertonit, ndërsa sulmuesi kuqezi nuk e fshehu gëzimin për rikthimin e tij në fushë pas një pauze kaq të gjatë: "Përshëndetje të gjithëve! Përshëndetje tifozëve të Evertonit! Faleminderit shumë që erdhët në ndeshjen time sot! Jam i lumtur që u riktheva nga dëmtimi dhe të jem në fushë.

Është një çast shumë i veçantë për mua. Jam shumë i lumtur për rikthimin. Ishte një fitore e mrekullueshme. Do të jemi sërisht të shtunën dhe ju presim ndaj Liverpoolit. Faleminderit shumë që erdhët, kjo do të thotë shumë". Jo vetëm fitorja 4-0, trajneri Sean Dyche u shfaq i kënaqur edhe për rikthimin e Armando Brojës: "Në thjesht dëshironim ta përfshinim në lojë. Ai ka pritur një kohë të gjatë, ka punuar shumë, shumë fort".

Mbappe: Marr përgjegjësinë e plotë për penalltinë

Madrid, 5 dhjetor - Kylian Mbappe ka reaguar pas humbjes së Real Madridit nga Athletic Bilbao në La Liga. Ylli francez e humbi penalltinë e dytë, pas asaj në ndeshjen

ndaj Liverpoolit në Ligën e Kampionëve. Edhe këtë herë, ishte portieri i cili ia priti penalltinë, në anën e njëjtë sikur ndaj Liverpoolit. E pas ndeshjes, Mbappe ka reaguar,

duke thënë se marrë përgjegjësinë e plotë për gabimin që bëri. "Rezultat i keq. Një gabim i madh në një ndeshje ku çdo detaj ka rëndësi. Unë marr

përgjegjësinë e plotë për të. Një moment i vështirë, por është koha më e mirë për të ndryshuar këtë situatë dhe për të treguar se kush jam", ka thënë Mbappe.



Ancelotti pas humbjes nga Bilbao: Barazimi do të ishte rezultat real

MADRID, 5 DHJETOR - Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, pas humbjes nga Athletic Bilbao (2-1), ka thënë se rezultati i barabartë dhe do të ishte real. "Ishte një ndeshje e komplikuar, e barabartë, konkurruese dhe e luftuar. Në

momentin që barazuam mund të kishim menduar të kontrollonim lojën, por detajet e vogla na penalizuan. E humbëm penalltinë, por nuk duhet ta vlerësoj ndeshjen për shkak të saj, sepse mund të shënohet ose jo. Mbappe është

i trishtuar dhe i zhgënjyer, por ne duhet të vazhdojmë. Ndeshja ishte e barabartë. Athletic Bilbao është një ekip shumë i rrezikshëm në shtëpi. Ne konkurruam dhe luftuam dhe loja ishte barazim për shkak të asaj që bënë të dyja

skadrat", ka thënë fillimisht Ancelotti. "Ne luajtëm një lojë të mirë në mbrojtje në pjesën e parë, por mund të kishim bërë më mirë me topin dhe nuk patëm shumë mundësi. Në pjesën e dytë ishte më mirë dhe patëm më shumë raste.



FIFA do ta hapë afatin e tretë të transferimeve shkaku i Kupës së Botës për Klube

NYON, 5 DHJETOR - FIFA nuk do të lë asgjë ta pengojë Kupën e Botës për Klube, që do të organizohet për herë të parë vitin e ardhshëm në një format të ri që përfshin 32 ekipe. Turneu njëmuor do të zhvillohet midis 14 qershorit dhe 14 korrikut, atëherë kur është pushimi midis sezoneve. Me premtim për pagesa të mëdha për 12 klubet evropiane të përfshira, FIFA do të organizojë një short të enjten në mbremje për të vendosur grupet. Formatin do të jetë i njëjtë me Kupën e Botës, me tetë grupe me nga katër, dhe fazat e eliminimit me 16 ekipe. Sipas gazetës "Marca", FIFA gjithashtu do të hapë një afat kalimtar të ri transferimesh. Organi drejtues i futbollit do të lejohet të skuadrat të bëjnë transferime midis 1 qershorit dhe 10 qershorit, për t'i nxirur klubet që të forcohen për garën dhe gjithashtu t'u japë atyre



mbulim ligjor. Një afat kalimtar i tretë i transferimeve do t'i lejojë lojtarët të lëvizin përpara turneut, pasi një efekt anësor i turneut do të jetë lejimi i klubeve t'i zgjasin kontratat e lojtarëve të tyre në mënyrë të njëanshme deri në fund të turneut. Lojtarët nuk do të lejohen të luajnë për dy ekipe të ndryshme gjatë Kupës së Botës për Klube. Shumica e kontratave përfundojnë më 30 qershor në

Evropë, ndërsa afati kalimtar veror hapet më 1 korrik, por rregulli i ri do t'i lejojë lojtarët të luajnë për tre ekipe të ndryshme në të njëjtin sezon. Gara e re ka marrë reagime të konsiderueshme, pas ankesave për shtyrjen e tepërt të lojtarëve elitare. Vetëm Real Madridi mund të luajë deri në 71 ndeshje këtë sezon, dhe yjet ndërkombëtarë padyshim që do të shkojnë përtej kësaj shifre.

SHKURT

Verstappeni: Dua ta mbyll sezonin me fitore

Ditën e diel do të zhvillohet gara e fundit sezonale e Botërorit 2024 në Formula 1. Do të garohet në Abu Dhabi, aty ku vëmendja është përqendruar te rivaliteti McLaren-Ferrari për titullin kampion për konstruktorë. Megjithatë, piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappeni, nuk i intereson kjo çështje dhe sheh punët e tij. Ai triumfoi pak ditë më parë në Katar dhe synon ta mbyllë mbarë këtë sezon, me një fitore edhe në Abu Dhabi. "Katari ishte një garë emocionuese dhe ishte bukur të fitonim sërish. Makina ishte shumë më e lehtë për t'u drejtuar dhe ishte një performancë e shkëlqyer nga i gjithë ekipi", ka thënë Verstappeni. "Në Abu Dhabi kam kujtime të mira. Do të ishte pozitive ta mbyllim sezonin me nota pozitive, duke përfutur nga konkurrenca mes McLarenit e Ferrarit. Nuk merremi me punët e tyre. Ne do të synojmë një tjetër fitore", ka shtuar Verstappeni.

Guardiola: Na duhej kjo fitore

Trajneri Pep Guardiola ka deklaruar se Manchester City duhej ta ndalte ecurinë negative me disa humbje radhazi në ndeshjen ndaj Nottinghamit, të cilin arriti ta fitonte me rezultat 3-0. "Na duhej kjo fitore. Klubi dhe lojtarët kishin nevojë për të fituar, por është vetëm një ndeshje. Problemet vazhdojnë me Manu dhe Nathan. Në përgjithësi, më e rëndësishmja ishte ta thyenim këtë rutinë negative dhe më në fund fituam, por duhet të vazhdojmë", tha ai. Guardiola më pas hodhi poshtë zërat se kishte një përçarje me Kevin De Bruyne: "Sezonin e kaluar ishte shumë muaj i lënduar dhe këtë sezon gjithashtu. Jam shumë i lumtur që është rikthyer. Ai luftoi shumë. Sa i përket fizikut të tij dhe minutave kundër Feyenoordit, nuk ishin të mira, prandaj vendosa që të mos luaj titullar në 'Anfield' (kundër Liverpoolit) për shkak të ritmit të lartë të kundërshtarit. Por minutat që luajti në 'Anfield' ishin shumë të mira dhe sot luajti 75 minuta fantastike".

Barça arrin marrëveshje me Jonathan Tah

Qendërmbrojtësi i Bayer Leverkusenit, Jonathan Tah, do të jetë pjesë e Barcelonës në afatin kalimtar të verës. Ky lajm është raportuar nga mediet e huaja. Duket se palët kanë arritur marrëveshjen dhe gjermani do të shkojë në verë si lojtar i lirë, pasi i skadon kontrata me kampionët e Bundesligës. Tash ka qenë një lojtar kyç për Leverkusenin, pasi luajti një rol jetik në sezonin e tyre fitues të titullit të Bundesligës edicionin e kaluar dhe është i njohur për aftësitë e tij të forta mbrojtëse dhe lidhshin në fushë. Barcelona mund të shesë mbrojtësin si Andreas Christensen dhe Ronald Araujo për të ndihmuar në financimin e lëvizjeve të ardhshme.

LeBroni nuk mjafton, lakersat turpërohen nga Miami

Los Anxhelos, 5 dhjetor - Los Angeles Lakers pësoi një humbje me rezultat 134-93 nga Miami, në një përballje pa histori dhe e komanduar nga vendasit. LeBron Jamesi realizoi 29 pikë, por që s'mjaftuan për ekipin kalifornian, ndërsa për Miamin shkëlqeu Tyler Herro me 31 pikë. Boston Celticsi i afrohet kreut të renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 130-120 ndaj Detroitit. Gjashtë lojtarë të Celticsit realizuan mbi 14 pikë, me Brownin që spikati



me 28 pikë, mbështetur edhe Porzingis me 26 pikë. Humbet edhe skuadra tjetër e Los Anxhelosit, clippersat, që u mundën me rezultat 108-80 në fushën e tyre nga Minnesota. Vendimtar stoli i skuadrës mike, nga erdhën 42 pikë, ndërkohë që më i miri ishte Randle me 20

pikë. Zhgënjeu edhe Milawukae, që u mund me rezultat 119-104 në shtëpi nga Atlanta, ku sërish lojtarët e stolit bëjnë diferencën, duke shënuar 50 pikë. Jashtë fushës fitoi edhe Orlandon, 106-102 ndaj Philadelphias (Wagner 35 pikë më i miri).

REZULTATET

Boston - Detroit	130-120
Brooklyn - Indiana	99-90
Miami - Lakers	134-93
Philadelphia - Orlando	102-106
Milwaukee - Atlanta	104-119
Clippers - Minnesota	80-108

Interi mund ta rikthejë Manen në Evropë

Sadio Mane mund ta bëjë një rikthim në futbollin evropian. Për këtë është i sigurt mediu spanjoll "Sport". Në fakt, 32-vjeçari mund të përfundojë në Itali, respektivisht tek Interi.

Aktualisht, futbollisti afrikan është pjesë e ekipit Al-Nassr, ku po luan së bashku me Cristiano Ronaldon, por ish-futbollisti i Liverpoolit e Bayern Munichut duket se dëshiron ta provojë

edhe një përvojë evropiane. Mane ka kontratë me klubin nga Saudi Pro League deri më 30 qershor të vitit 2026, por "Nerazzurri" mund ta bindë atë që të rikthehet në Kontinentin e

Vjetër.

Mane ka qenë lojtar i jashtëzakonshëm në Premierligë duke fituar gjithçka që është e mundshme me "Reds", ndërsa në Bundesliga me gjigantin

bavarez e pati një përvojë për t'u harruar. Sidoqoftë, ai mund t'i japë kontribut të madh Interit nëse përfundon aty nga janari e tutje pasi ndihet ende në formë të mirë fizike.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn, Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8, dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 06.12.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës:

KONKURS

Pozita : Zyrtar i burimeve njerëzore - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar
Koeficienti i pagës : 3

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Organizon, koordinon dhe udhëheq me punët e përgjithshme të departamentit të administratës së përgjithshme;
2. Merr pjesë në mbledhjet e personelit udhëheqës dhe mbledhje tjera sipas nevojës dhe kërkesës së eprorit linear;
3. Koordinon punët me sekretarin dhe kryen urdhëresat e tyre në lidhje me aktet normative, kontratat e punës dhe vendimet administrativo-juridike;
4. Merr pjesë në hartimin e akteve të përgjithshme juridike dhe rregullave të punës dhe harmonizimin e tyre me dispozitat pozitive ligjore;
5. Kujdeset për udhëheqjen e evidencave të punëtorëve, të protokollit, arkivës dhe të gjitha evidencave tjera që lidhen me personelin;
6. Këshillon palët dhe punëtorët e ndërmarrjes, ju jep udhëzime mbi të drejtat dhe obligimet e tyre;
7. Bën organizimin e zyrave dhe lëvizjen e personelit të ndërmarrjes për të mundur administratë funksionale;
8. Përkujdeset për ngritjen e performancës së personelit dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara;
9. Kryen edhe punë tjera në kuafij të autorizimeve të veta dhe të atyre që ia beson sekretari dhe KE;
10. Bashkëpunon me personat përgjegjës në hartimin e planit mbi shfrytëzimin e pushimit vjetor të punëtorëve dhe përgatit raportet rreth veprimit të punëve dhe detyrave;
11. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e disiplinës në punë të punëtorëve në kuadër të këtij departamenti dhe ndërmarrjes në përgjithësi;
12. Në baza të rregullta muajore përgatit raport për sekretarin për punët e përgjithshme në kuadër të departamentit të administratës;
13. Udhëheq punët në shërbimin e administratës, burimeve njerëzore dhe personelit;
14. Kujdeset për azhurnimin dhe mirëmbajtjen e librit amzë (versionit elektronik) të të punësuarve;
15. Kujdeset për kryerjen e të gjitha punëve që kanë të bëjnë me formimin e evidencave përkatëse për punëtorë, bën paraqitjen e punëtorëve, përgatit raportet statistikore për burimet njerëzore dhe përgatit të dhënat për përpunimin kompjuterik mbi evidencat për punëtorë;
16. Në koordinim me departamentet gjegjëse harton planin për rekrutimet e reja;
17. Përgatit dhe kujdeset për zhvillimin e rregullt të procedurave të rekrutimit të punëtorëve të ri në pas urdhëresave që merr nga KE;
18. Merr pjesë në ç'do procedurë disiplinore dhe materiale që zhvillohet kundër punëtorëve të ndërmarrjes, në cilësinë e anëtarit të komisionit disiplinor ex-officio;
19. Përpilon vendimet për largime të përkohshme, shkëputje të kontratave të punës, themelimin e marrëdhënies së punës, aktvendimet e tjera që lidhen me marrëdhëniet e punës në kompani;
20. Përpilon kontratat e punës për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes pas konsultimit me sekretarin dhe KE;
21. Kujdeset për përfshirjen e ndryshimeve të aprovuara në aktin e sistematizimit të vendeve të punës të ndërmarrjes;
22. Kujdeset për distribuimin me kohë të vendimeve nga spektri i punëve përkatëse, si dhe kryen punë të tjera sipas urdhrat të eprorit linear;
23. Përgatit dhe dërgon me kohë raportet (ilogarinë) muajore për punë për ilogaritjen e të ardhurave personale për punëtorët e shërbimit;
24. Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore për raportimin e tyre të eprorit linear;
25. Kryen punë të tjera me urdhëresë të Sekretarit Korporativ të Ndërmarrjes;
26. Për mos respektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejtë, Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hotime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Diplomë Universitare: fakultetit juridik, administratë publike; burime njerëzore;
- Përvoja e punës: 3 vite e dëshmuar;
- Ai/Ajo duhet të ketë përvojë të menaxhimit apo profesioneve relevante, aftësi organizative dhe analitike, dhe aftësi ndër njerëzore;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.)

Mënyra e Aplikimit: Dokumentacioni duhet të dërgohet në e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 06.12.2024 deri me 23.12.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erik Qorri nga Gjakova shpall të gjata dhe të shkurtra. Informata në pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 tel: 049\44-888-801 (viber) dhe diplomën e sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" dhe certifikatën e maturës.
- Vera Jaha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044\171-328.
- Lëshohet banesa e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN;
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909
0.5L



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

